



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e faturës së papaguar të ujit të krijuar (shpenzuar), në objektin në të cilin gjendet “Shoqata Rajonale Shurdhmemece” në Prizren, kështu që, në emër të pagesës së faturës përkatëse të Kompanisë Rajonale të Ujësjetllësit “Hidroregjioni Jugor” sh.a, në Prizren, përkatësisht për faturën e papaguar me nr. të KONS-0029889, lejohen mjetet financiare në shumën prej 1.118,79 € (njëmijë e njëqind e tetëmbëdhjetë euro e shtatëdhjetë e nëntë cent).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe shpenzime komunale të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.